

FJALA E DEPUTETES ERISA XHIXHO

E ENJTE 17 NËNTOR 2022

E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Në fakt, debati për procesin e integritit europian të Shqipërisë është një nga debatet më të rëndësishme për qytetarët shqiptarë, prandaj ne duhet të jemi të vërtetë e t'i themi gjërat ashtu siç janë për t'u përmirësuar dhe për të avancuar në këtë proces madhor për shqiptarët. Ndaj, diskutimi i sotëm për progresraportin e Bashkimit Europian është skaneri më i vërtetë i qeverisë, sepse i jep zë shumë shqetësimeve të ngritura nga ne rishtazi. Më lejoni të ndalem në disa prej pikave dhe të them disa të vërteta për shqiptarët. Sipas raporti të Bashkimit Europian numri i shtetasve shqiptarë që paraqesin kërkesa për azil në shtetet anëtare të Bashkimit Europian është rritur ndjeshëm në verën e vitit 2021. Këto janë të vërteta, që shqiptarët po largohen masivisht nga keqqeverisja.

Të rinjtë shqiptarë hyjnë çdo ditë në Britani në mënyrë të paligjshme, këto janë të vërteta, kërkesat për azil, me të cilat ia kalojmë edhe Ukrainës, që është në luftë, shkolla dhe programe studimi që mbyllen çdo vit, fshatra të tërë që zbrazen, që kanë vetëm pensionistë që kanë ngelur aty, këto janë të vërtetat, të cilat janë të pasqyruar edhe në progresraport. Në fakt, çfarë ka bërë ky parlament? Ka dështuar në mënyrë spektakolare në përafrimin e legjislacionit, vetëm 9 ligje kanë qenë të përafuara me BE-në. Këtë e thotë progresraporti i Bashkimit Europian. Me forcën e numrave shembin teatrin, me forcën e kartonëve japin me koncesion historinë e vendit dhe miratojmë ligje speciale për klientët e tyre. Këto janë të vërtetat.

Nuk kemi bërë progres në luftën kundër korrupsionit, thuhet në progresraport. Korrupsioni në Shqipëri mbetet fusha që përbën shqetësim serioz, i shtrirë në çdo degë të pushtetit vendor dhe qendror, korrupsioni është marka e kësaj qeverie, sepse përmes tij gjeneron miliona euro nga xhepat e shqiptarëve, duke i lënë të varfër edhe në këto ditë të vështira krize. Po cilat janë nismat që do ta pengojnë procesin e integritit europian të ndërmarra nga kjo qeveri? Së pari, progresraporti vë theksin se: "Shqipëria duhet të frenohet nga zhvillimi i një skeme të nënshtetësisë së investitorëve, pasaportat e arta, pasi do të përbënte rreziqe për sa i përket sigurisë, pastrimit të parave, evazionit fiskal, financimit

të terrorizmit, korrupsionit dhe infiltrimit nga krimi i organizuar dhe do të ishte i papajtueshëm me acquis të BE-së”.

Kjo qeveri nuk e ka problem ta kthejë vendin në lavatriçe të pastrimit të këtyre parave në dëm të integritit të vendit dhe në kurriz të shqiptarëve të ndershëm, por nuk mjaftohet me këtë iniciativë që progresraporti e thekson. “Amnistia tatimore dhe penale është kundër këshillave të BE-së dhe MONEYVAL-it, ndaj mund të rrezikojë përparimin në luftën kundër pastrimit të parave”, thuhet në progresraport. Ndërkohë që Shqipëria është në zonën gri raporti ngre shqetësimin e pengesave që do të sillte kjo amnisti dhe iniciativë e qeverisë shqiptare. Çfarë është bërë me lirinë e medias dhe të fjalës, një ndër të drejtat themelore të qytetarëve shqiptarë?

Nuk kemi progres dhe kjo është vërtet e dhimbshme, sepse cenimi i pavarësisë së mediave, frikësimi i gazetarëve, mungesa e aksesit në institucionet qeveritare, mungesa e transparencës dhe e pavarësisë së Radiotelevizionit Shqiptar tregojnë se nuk mund t’i afrosh Europës, nëse nuk ke të drejtën e fjalës dhe lirinë e medias të sanksionuar në vend. Çfarë bëhet me buxhetin për arsimin në progresraport, i cili është nga shtyllat kryesore që duhet të kishte një vend, i cili aspiron Bashkimin Europian? Jemi shumë larg, sepse buxheti i arsimit është më i ulëti, ishte i tillë për vitin 2021, por përsëri edhe për vitin 2013 është shumë larg standardeve të Bashkimit Europian.

2,2% të PBB-së parashikohet projektbuxheti i arsimit për vitin 2023, shumë larg mesatares së Bashkimit Europian 5%, si dhe shumë larg premtimit tuaj 5%, të cilin duhet ta kishit përmbushur që në krye të herës. Çfarë thuhet për megaafërën e inceneratorëve ky progresraport? Inceneratori i Tiranës paraqet shqetësime në rritje sa i përket përputhshmërisë së acquis-ë me Bashkimin Europian për mbetjet, duke përfshirë hierarkinë e mbetjeve dhe objektivat e riciklimit. Raporti i cilëson politikat e menaxhimit të mbetjeve jo në përputhje me objektivat e Bashkimit Europian dhe kuadrin ligjor pjesërisht të përafrit, në fakt, kjo, sepse inceneratorët nuk janë në përqasjen e Bashkimit Europian për riciklimin e mbetjeve.

Kjo qeveri, e cila e kërkon kaq shumë integrimin vendos të implementojë inceneratorë për mbetjet, duke u vjedhur shqiptarëve plot 420 milionë euro. Kjo qeveri nuk e ka pasur prioritet integrimin që nga viti 2017, ku me vendimin e saj të parë shkatërroi të gjithë Ministrinë e Integritit, duke thënë dhe dhënë një mesazh që integrimi europian nuk do të jetë më në prioritetet kryesore të kësaj qeverie. Rasti më flagrant, kur themi se do të jemi drejt qasjes europiane dhe në fund legjislacionin e Bashkimit Europian e përdorim me dy standarde, është ai portit të Durrësit, një projekt pa garë, pa transparencë dhe në kundërshtim me MSA-në. Këto janë të vërtetat. Për mua integrimi europian shkon përtej çdo

partie politike, për ne integrimi europian është puna e përditshme, përmbushja e detyrimeve, plan pune ku do të duhet të ndërtojmë standardet europiane të shtetit ligjor dhe të demokracisë për qytetarët tanë.

Ky nuk është procesi i njëjës apo i tjetrës palë, ky është procesi i të gjithë shqiptarëve dhe, në fakt, duke qenë i tillë do të duhet që ky Kuvend të japë shembullin më të mirë në Këshillin e Integritit Europian, duke miratuar sa më shpejt propozimin tonë, që Këshilli Europian të jetë sa më gjithëpërfshirës me të gjithë aktorët politikë në vend. Faleminderit!